



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika d, nenit 17, pika (b) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28 qershor 2008), neni 11, paragrafi 1 pika 1.15, neni 17 paragrafi 5, nenit 20 dhe nenit 26, të Ligjit nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor, nenit 7, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.05/2014, dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, dhe shkresës së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor 2517-2/16 dt. 08.06.2016, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 30.09.2016, merr këtë:

V E N D I M
PËR LËNIE NË DISPOZICION PËR SHQYRTIM PUBLIK TË PROPOZIMPLANIT
RREGULLUES TË HOLLËSISHËM TË LAGJES "KODRA E TRIMAVE 1"

Neni 1

1. Miratohet Vendimi për lënie në dispozicion për shqyrtim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm "Kodra e Trimave 1" në Prishtinë.
2. Propozimplani, nga pika I e këtij vendimi, përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike, të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi.

Neni 2

1. Propozimplani rregullues i hollësishëm, i cekur në pikën I të këtij vendimi, u lihet në dispozicion për diskutim publik qytetarëve, agjencive, departamenteve dhe organeve të tjera për shqyrtim dhe komente, në afat prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e parë vijuese pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
2. Organizimin e diskutimit publik të Propozimplanit, do ta bëjë Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Neni 3

1. Pas përfundimit të kohëzgjatjes së shqyrtimit publik, Projektplani final së bashku me një përmbledhje të shkurtër të komenteve të bëra gjatë shqyrtimit publik - raportin, do ti dorëzohet Kuvendit të Komunës së Prishtinës për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.

Neni 4

1. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.
2. Organet tjera përkatëse kompetente, do t'i kryejnë veprimet procedurale për zbatim të këtij Propozimplani nga përgjegjësitë e tyre të parapara sipas Vendimit për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës komunale.

Neni 5

Territori i Planit Rregullues i Hollësishëm i lagjes „Kodra e Trimave1” ka sipërfaqe = 340 Ha, Ky plan kufizohet me Kodren e Trimave 2, Arberia 3, Tophane

Neni 6

Mjetet për hartimin e dokumentit të planifikimit hapësinor janë siguruar nga buxheti i komunës së Prishtinës, në bazë të kontratës të lidhur në mes të Komunës së Prishtinës dhe NNSH "A Design" - Prishtinë, me numër identifikues 616 12 105 221 dt. 21.11.2012, kontraktorit të përzgjedhur nga konkursi i projektimit sipas Ligjit Nr. 03/L-241 Për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës).

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.nr. 031-247798, më 04.10.2016



KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi, jur. i dipl.

A R S Y E T I M
I VENDIMIT PËR LËNIE NË DISPOZICION PËR PUBLIKUN TË
PROPOZIMPLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM "KODRA E TRIMAVE 1"

Në bazë të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-035-1018, dt. 16.7.2008, ka filluar hartimi i Planit rregullues të hollësishëm "Kodra e Trimave 1".

Bazuar në këtë vendim, Ligjin nr. 2003/14, për planifikim hapësinor, dt. 3.7.2003, dhe Udhëzimin administrativ mbi elementet themelore të Planit rregullues, nr. 41, dt. 4.3.2005, Kryetari i komunës, ka përgatitur detyrën projektuese për hartimin e këtij niveli të planifikimit, në bazë të së cilës është shpallur tenderi dhe është zgjedhur ofertuesi për hartimin e Planit rregullues të hollësishëm "Kodra e Trimave 1" në Prishtinë.

Sipas detyrave projektuese të hartuara nga Kryetari i Komunës, Departamenti i Prokurimit ka publikuar ofertat për zgjedhjen e kompanisë projektuese, dhe pas përfundimit të këtyre procedurave konkurruese, NNSH "A Design" - Prishtinë është përzgjedhur kompania fituese për hartimin e këtij plani, dhe mbi këtë bazë është nënshkruar kontrata me numër identifikues

616 12 105 221, e datës 21.11.2012, ku janë përcaktuar detyrat, kushtet dhe afatet për hartimin e Planit rregullues të hollësishëm në mes të kompanisë përfituese "A Design", në njërën anë, dhe Komunës së Prishtinës, në anën tjetër.

Për hartimin e këtij Plani, në përputhje me dispozitat ligjore, gjatë takimeve dhe punëtorive, përveç përfaqësuesve të kompanisë projektuese, është angazhuar edhe stafi profesional i Komunës së Prishtinës.

Gjatë punës për hartimin e këtij Plani, kompania hartuese fillimisht ka dorëzuar planin dinamik për hartimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues të hollësishëm "Kodra e Trimave 1", në përputhje me afatin ligjor të paraparë me kontratën e lartshënuar dhe atë:

Faza e parë:

- I. Incizimi gjeodezik;
- II. Identifikimi i informatave që duhet grumbulluar;
- III. Analiza e pjesëmarrësve;
- IV. Përgatitja e profilit urban;
- V. Vlerësimi i situatës në lokacion;
- VI. Konsultimet për procesin e planifikimit.

Faza e dytë:

- I. Opsionet e zhvillimit;
- II. Prezantimi i zgjidhjeve të mundshme, konkretisht tre skenarë;
- III. Hartimi i planit rregullues.

Faza e tretë:

- I. Diskutimi, shqyrtimi publik dhe miratimi i planit.

Kompania hartuese e lartcekur ka vazhduar me punën e mëtejme rreth hartimit të këtij plani, dhe gjatë kësaj periudhe, përkatësisht fazës së parë dhe të dytë, janë mbajtur takime profesionale.

Procedura për hartimin e Planit rregullues të hollësishëm "Kodra e Trimave 1", ishte pezulluar nga ana e MMPH-së, me njoftimin e dt. 29.11.2013, për shkak të Ligjit të ri të planifikimit dhe akteve nënligjore të cilat duhet të nxirren. Për këtë arsye është zgjatur afati i dorëzimit të materialit.

Kompania hartuese ka dorëzuar materialin (pjesën tekstuale dhe grafike), gjegjësisht këtë propozimplan, tek Kryetari i Komunës për ta përcjellë këtë material në Këshillin e Drejtorëve dhe Komiteti për Planifikim dhe Urbanizëm. Materiali është dorëzuar në tri kopje të forta dhe 10 kopje elektronike (CD).

Pasi që faza e dytë e lartcekur ka përfunduar, atëherë kompania hartuese e kontraktuar, së bashku me Kryetarin e Komunës dhe stafin mbikëqyrës të kësaj kontrate, në vazhdimësi do t'i vazhdojë procedurat e tjera të radhës të parapara sipas Ligjit për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor, si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor, përkatësisht do ta përcjellë këtë material të dorëzuar te Komiteti për Planifikim dhe Urbanizëm për miratim.

Bazuar në Ligjin për planifikimin hapësinor, ky propozimplan rregullues është i nevojshëm të miratohet nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, dhe njëkohësisht të organizohet debati publik, në mënyrë që pas përfundimit të tyre dhe plotësimit të procedurave të tjera ligjore, të prezantohet për miratim përfundimtar në Kuvendin e Komunës së Prishtinës.

Menaxher i Planit rregullues: Hazir Zhitija, inxh. i dipl. ark.

Mbikëqyrës:

Zana Ismajli, inxh. i dipl. ark,

Makfired Avdullahu, msc,

Ferit Fazliu, inxh. i dipl. ndërtim.

Merita Rushiti, inxh. I dipl. hydr.

Avdurrahman Krasniqi, inxh. i dipl. elekt.

Daut Humolli, inxh. i dipl. makin.

Krenare Shkodra, msc. Arch.